



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

Numri i lëndës: 2020:117834

Datë: 21.08.2024

Numri i dokumentit: 06071067

P.nr.7/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Leposaviq - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetëm gjykues Qëndresa Tahiri Islami, me bashkëpunëtoreshen profesionale Edita Koliqi, në çështjen penale ndaj të pandehurit: M.P, për shkak të veprës penale: Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (*tutje si*: KPPK), sipas Aktakuzës PP.I.nr.117/2013, të datës 05.01.2018, të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 12.08.2024, në mungesë të Prokurorit të Shtetit Muharrem Prekazi, të pandehurit M.P, si dhe mbrojtësit të pandehurit sipas autorizimit me shkrim, avokat Millosh Deleviq, në po të njëjtë ditë shpalli publikisht, ndërsa me datë 21.08.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

M.P, me nofkën "...", nga i ati P..., e ëma T..., e vajzërisë R..., i lindur me datë ..., në T... – S..., me vendbanim në rrugën ".....", nr....., fshati Z...- L..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, pensionist, me numër personal, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 16.05.2012, rreth orë s 22:00, në shtëpi në fshatin Z... – K.L... ka mbajtur dhe përdor armë pushkë dytytëshe të kalibrit 16mm me nr. serik prodhim rus, ashtu që në gjendje të dehur i pandehuri M... provon me dhunë ta largoj nga shtëpia nipin tij M..., e kur ai rezistoi atëherë i pandehuri merr pushkë në dorë dhe drejton në drejtim të dëmtuarit M..., Zh... e cila

i drejtohet të pandehurit M... “ se çka po ban ashtu” dhe fillon kacafytja me të pandehurin dhe arrin të ja merr pushkë n prej dore duke e shtyrë të pandehurin e rrëzon në shtrat, ndërsa i dëmtuari largohet nga shtëpia,

-Me këtë ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 2, 3, 6, 11, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 39, 64, 65 dhe nenit 328 të KPPK-së dhe nenit 358, 364, 449, 462 të KPP-së, i:

S H Q I P T O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilën dënim-gjobë obligohet ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan këtë gjobë, atëherë Gjykata do të veproj në bazë të nenit 39 të KPPK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t`ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 15 (pesëmbëdhjetë) euro gjobë.
- II. Në mbështetje të nenit 276 par.1 dhe 2, nën-par.2.1 të KPP-së, si dhe nenit 328 par.5 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, KONFISKOHET sendi, dhe atë:
 - a. Arma – pushka dytytëshe 16 mm, me numër serik e prodhimit rus.
- Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, kjo armë duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, pasi që të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë krim tjetër.
- III. Obligohet i pandehuri, që t`i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumëën prej 20 (njëzet) euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumëën prej 20 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- IV. Pala e dëmtuar M.P1 me të dhënat personale si në aktakuzë , për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.117/2013, të datës 05.01.2018, ndaj të pandehurit: M.P për shkak të veprës penale: Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të KPPK-së.

Rrjedha e procedurës

Gjykata, me datë 12.08.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e palëve, Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Muharrem Prekazi, të pandehurit M.P dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit me shkrim, avokat Millosh Deleviq.

I pandehuri M.P, gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga gjykata me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale dhe leximit të aktakuzës, ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale sipas aktit akuzues dhe ka shprehur keqardhje e kërkim falje për rastin e ndodhur.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve në lidhje me deklarinimin mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit Muharrem Prekazi, ka japur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri. I njëjti i propozoi Gjykatës që të miratoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, po ashtu pranimi i fajësisë gjen mbështetje në shkresat e lëndës. Lidhur me rrethanat e matjes së dënimit, propozoi që Gjykata të pandehurin ta shpall fajtor, të i shqiptoj një dënim të drejtë dhe ligjor me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, duke marr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethanë rënduese ka propozuar që të merret fakti se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjarë , ndërkaq si rrethana lehtësuese, pranimin e fajësisë , moshën e shtyer të pandehurit dhe keqardhjen e shprehur.

Mbrojtësi i të pandehurit M.P, avokat Millosh Delqviq, ka propozuar që Gjykata të miratoj pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, pasi që është bërë pas konsultimeve të

mjaftueshme me të si mbrojtës. Lidhur me rrethanat e matjes së dënimit, si rrethanë lehtësuese ka propozuar që të merret parasysh koha e kryerjes së veprës penale dhe faktin se që nga ajo kohë e deri më sot i pandehuri nuk ka ra asnjë herë ndesh me ligjin, si dhe faktin se me të dëmtuarin kanë raporte të mira.

Gjetjet e Gjykatës

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri M.P, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimin të fajësisë për të pandehurit. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2012/BE/071 i datës 16.05.2012; Raportet policore; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së të dëmtuarit M.P1 i datës 16.05.2012; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitares Zh.P i datës 16.05.2012; Procesverbali mbi intervistimin e të pandehurit M.P i datës 16.05.2012; Shënimet zyrtare; Lista mbi marrjen e sendeve e datës 16.05.2012; Formulari i regjistrimit të armëve; Shkresat nga forenzika dhe lista e provave; Foto albumi nga shkresat e lëndës; si dhe shkresat e tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese, e që në bazë të tyre dhe pranimin të fajësisë nga i pandehuri, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale sipas aktit akuzues.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë është bërë nga i pandehuri në mënyrë vullnetare, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë. Gjykata ia kishte tërheq vërejtjen të pandehurit se pas pranimin të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga të pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri M.P është i përgjegjshëm dhe përgjegjës për veprën penale për të cilën akuzohet, Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin M.P, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 64 dhe 65 të KPPK-ës, e si rrethanë rënduese ka vlerësuar, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij në veprën penale, vepra penale ishte kryer brenda marrëdhënies familjare, faktin se natyra e këtyre veprave penale janë të shpeshtuara në Kosovë, rrezikshmërinë që paraqesin këto vepra penale.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese për të pandehurin M.P ka marrë për bazë se i njëjti ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në raport me Gjykatën dhe palët, faktin që ka kaluar një kohë e gjatë nga kryerja e kësaj vepre penale, plotë 12 vite dhe që nga ajo kohë i pandehuri më asnjë herë nuk ka ra ndesh me ligjin, pastaj keqardhjen e shprehur për veprimet e kryera penale dhe kërkim faljen e dhënë para Gjykatës, me të dëmtuarin kanë raporte të mira, si dhe si rrethanë lehtësuese po ashtu u marrë edhe mosha e shtyer e të pandehurit. Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që akuzohet.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar më gjobë ndaj të pandehurit M.P, në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprave penale dhe rrethanat e tjera që i kemi cekur më lartë, është adekuat dhe ne si Gjykatë jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat e tjerë, që në të ardhmen të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, Gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

Konfiskimi

Gjykata në mbështetje të nenit 276 par.1 dhe 2, nën-par.2.1 të KPP-së, ku përcakton se armët të cilat janë krijuar apo përdorur në veprën penale nga nenet 364 deri me 369 të Kodit Penal, dispozita këto ekuivalente me nenin 328 të KPPK-së, pasuria që është qenësish e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marrë parasysh edhe gjetjet e gjyqtarit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit, e po ashtu duke u bazuar në paragrafin 5 të nenit 328 të

KPPK-së, andaj për shkak të këtyre konstatimeve gjykata ka vendosur si në dispozitiv për konfiskimin e tyre.

Gjykata rikujton se i pandehuri nuk kishin leje e as autorizim për posedimin e armës. Në anën tjetër sendet e lartcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike nga këto arsye gjykata ka vendosur t'i konfiskoj përherë dhe të njëjtat ka urdhëruar që të shkatërrohen. Gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e përhershëm të armës sipas nenit 328 par.5 të KPRK-së, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, Gjykata bazuar në nenin 462 të KPP-së, të dëmtuarin e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko – civil.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 358, 364, 449, 462 të KPPK-së nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Leposaviq
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.7/2018, datë 21.08.2024

Bashkëpunëtoresh Profesionale:
Edita Koliqi

Gjyqtarja:
Qëndresa Tahiri Islami

KËSHILË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.